



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2024:009104

Datë: 07.05.2024

Numri i dokumentit: 05657277

P.nr. 10/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË/ DEGA NË MALISHEVË - DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL, gjyqtari i vetëm gjykues Njazi Morina, me bashkëpunëtorin profesional Samir Morina, në lëndën penale kundër të akuzuarve: Q. M. nga Malisheva, për shkak të veprës penale sulm nga neni 184 par. 1 të KPRK-së dhe M. Th. nga fshati M., Komuna e Malishevës, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 2 lidhur me par.1 nën par.1.4 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë me numër PP/II.nr. 1357/2023 të datës 12.01.2024 në shqyrtimin fillestar të mbajtur më 11.03.2024, në prezencën e prokurorit të shtetit Kastriot Memaj, i akuzuari Q.M. dhe i akuzuari M. Th., së bashku me mbrojtësen e tij Liri Krasniqi, avokate në Malishevë, më 14 mars 2024, nxjerri dhe publikisht shpalli këtë:

AKTGJYKIM

I akuzuari **Q. M.** i lindur më ... në M., nga i ati S. dhe e ëma E., e gjinisë G., i martuar, ka të kryer Fakultetin e Gj., punon taksist i gjendjes së dobët ekonomike, i dënuar më parë, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

I akuzuari **M. TH.** i lindur më ... në fshatin M., Komuna e Malishevës, nga i ati F. dhe e ëma F., e gjinisë H., i martuar, atë i 5 (pesë) fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, veteran, i gjendjes së mesme ekonomike, i dënuar më parë, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

I.

I akuzuari **Q. M.**,

ËSHTË FAJTOR

SEPSE,

Më 30.08.2023, rreth orës 14:17 minuta ne Rr. "A. J." ne M., përballë lokalit "V.", i pandehuri Q.M. me dashje përdor forcën ndaj këtu të dëmtuarit M. Th., ne atë mënyrë që ditën kritike mes tyre fillojnë disa mosmarrëveshje për shkak të një shërbimi taksie që kishte bere i pandehuri për të dëmtuarin lidhur me dërgimin e tij për ne aeroport dhe anasjelltas dhe me të kthyer në Malishevë i pandehuri ndalon veturën para lokalit "V." dhe nga i dëmtuari kërkon pagesën e shërbimit, me ç' rast i dëmtuari refuzon që t'ia benë pagesën me arsyetimin se paraprakisht ishin marr vesh që marrëveshja ishte që

ta kthen ne shtëpinë e tij në shatin M., Komuna e Malishevës, ashtu qe i dëmtuari i cili ishte i shoqëruar me mbesën e tij 7 vjeçare detyrohet qe te del nga vetura e taksisë se te pandehurit, për shkak edhe revoltohet i pandehuri dhe ne një moment me shkelm e godet ne këmbën e djathte te dëmtuarin, me ç' rast tek i njëjti shkakton dhimbje dhe shqetësim emocional.

- me çka ka kryer veprën penale sulm nga neni 184 par.1 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të nenit 3,4,7,17,38,39,43,69,70,184 par. 1 të KPRK-së, dhe neneve 241,242,364 të KPP-së, të akuzuarit **Q. M.** i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Të akuzuarin **Q. M.** e dënon me dënim me gjobë në shumën prej dyqind e gjashtëdhjetë (260) euro, të cilin dënim është i detyruar ta paguaj brenda afatit prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit.

Nëse personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj gjobën, gjykata në bazë të nenit 43 paragrafi 3 të KPRK-së, dënimin me gjobë do ta zëvendësoj me dënim burgimi në kohëzgjatje prej trembëdhjetë (13) ditësh, duke llogaritur për çdo ditë të qëndrimit në burgim, nga njëzet (20) euro.

Detyrohet i akuzuari që në emër të kompensimit të viktimave të krimit ti paguaj shpenzimet në shumën prej 20,00 €, si dhe shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumën prej 20,00 €, në afatin prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II.

I akuzuari **M.TH.**,

ËSHTË FAJTOR

SEPSE,

Më 30.08.2023, rreth orës 14:25 minuta ne shatin M., Komuna e Malishevës, ne shtëpinë e tij, i pandehuri M. T. me dashje i shkakton lëndime te lehta trupore te dëmtuarit Q.M., me mjet te rrezikshëm qe mund të shkaktoj lëndim te rënde trupore ose dëmtim te rëndë për shëndetin, ne atë mënyrë qe ditën kritike pasi qe për shkak te mosmarrëveshjes mes vete lidhur me shërbimin e taksisë te përshkruar si në piken nën I te dispozitivit nuk e paguan shërbimin të dëmtuarit, ashtu qe i njëjti shkon në shtëpinë e te pandehurit M. në fshatin M., Komuna e Malishevës, nga i cili kërkon qe t'ia kryen pagesën për shërbimin e taksisë për shkak edhe revoltohet i pandehuri i cili e merre një shkop druri e godet disa here te dëmtuarin në pjesën te ndryshme te trupit si në shpine, koke, këmbë, duke i shkakuar ndrydhje te indeve te buta në regjionin e kokës dhe regjionin e kërcirit te djathte dhe ndrydhje dhe gjake mbledhje nën lëkurore ne regjionin e shpinës dhe regjionin e kërdhokullës se majte, me ç' rast te dëmtuarit i shkakton lëndime te lehta trupore me dëmtim te përkohshëm për shëndetin, te përshkruara si ne akt ekspertizën mjeko ligjor nga Dr. N. U. me nr. referencës Gja-... të datës 12.10.2023.

- me çka ka kryer veprën penale lëndim i lehtë truporë nga neni 185 par.2 lidhur me par. 1 nën par. 1.4 të KPRK-së.

Andaj, Gjykata ma aplikimin e neneve 4,6,7,17,38,39,40,42,69,70,185 par.2 lidhur me par. 1 nën par. 1.4 të KPRK-së, si dhe neneve 241,242,358 par. 2,364,365,449 par. 1 dhe par. 2, nën par. 2.1 dhe 2.6 të KPP-së, të akuzuarin **M. TH. e**,

G J Y K O N

Me dënim me burgim ne kohëzgjatje prej **NJËQIND (100) DITËSH**, të cilin dënim është i obliguar që ta vuaj 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Detyrohet i akuzuari që në emër të kompensimit të viktimave të krimit ti paguaj shpenzimet në shumën prej 20 €, për shpenzimet e ekspertizës mjeko ligjore në shumën prej 20 €, si dhe për shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumën prej 20 €, të gjitha këto në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Gjakovë, në këtë gjykatë ka paraqitur aktakuzë PP/II.nr. 1357/2023, të datës 12.01.2024, kundër të akuzuarve: Q.M. nga M., për shkak të veprës penale sulm nga neni 184 par. 1 të KPRK-së dhe M. Th. nga fshati M., Komuna e Malishevës, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 2 lidhur me par.1 nën par.1.4 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimin fillestar më datë 11.03.2024, dhe pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, të pandehurve iu dha mundësia për ta pranuar fajësinë apo të deklarohen të pafajshëm.

Pas deklarimit të pandehurve se ndjehen fajtor për kryerjen e veprave penale për të cilat akuzohen nga Prokuroria, gjykata me Aktvendim pranoi pranimin e fajësisë nga të pandehurit pasi që është bindur plotësisht se ishin të vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë.

Prokurori i shtetit deklaron se: pajtohem me deklarimin e fajësisë, meqenëse është bërë vullnetarisht nga ana e të pandehurve dhe ky pranim fajësie gjen mbështetje të plotë në shkresat e lëndës të cilat i janë bashkangjitur aktakuzës, andaj i propozojë gjykatës që të pranoj pranimin e fajësisë, të pandehurit ti shpall fajtor për veprat penale me të cilat ngarkohen, ndërsa me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjegjësisht individualizimi i dënimit në këtë çështje penale të marr për bazë të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese sipas pikës 4 të aktakuzës.

I akuzuari Q.M. deklarohe i fajshëm për veprën penale për të cilën ngarkohem, të njëjtën e pranoj në mënyrë vullnetare, është e vërtet se ja kam dhënë një shkëllm në këmbën e djathtë M.T.

Mbrojtësja e të akuzuarit M. T., avokate Liri Krasniqi deklaron se: meqenëse i pandehuri e ka pranuar fajin, në këtë fazë fillestare kërkoj nga gjykata që të merren si rrethana lehtësuese këto fakte, pranimi i fajësisë, gjendja e tij ekonomike, pendimi i thellë i klientit tim, bazuar në këto të lartë cekura të pandehurit ti shpall një dënim sa më të butë.

I akuzuari M. Th. deklarohet i fajshëm për veprën penale për të cilën ngarkohem, të njëjtën e pranoj në mënyrë vullnetare.

Nga thëniet e vet të akuzuarve në shqyrtimin fillestarë u vërtetua se ata me datë, kohë dhe vend si në dispozitivin e aktakuzës së ngritur ndaj tyre kanë kryer veprat penale për të cilat akuzohen.

Po ashtu nga shkresat e lëndës dhe nga provat materiale siç janë: raporti fillestar i incidentit nr. ... dt. 30.08.2023; raporti i policit D. S., nr. ... dt. 30.08.2023; procesverbali i marrjes në pyetje për të dyshuarin Q.M., e dhënë në Stacionin Policor në Malishevë me datë 30.08.2023; procesverbali i marrjes në pyetje për të dyshuarin M. Th., e dhënë në Stacionin Policor në M. me datë 30.08.2023; akt ekspertimi mjeko-ligjor i ekspertit Dr. N. U. me nr. reference: Gja-... e datës 12.10.2023; CD-ja me nr. të rastit ...; foto dokumentacioni dhe shkresat e tjera të lëndës.

Gjykata me pranimin e fajësisë nga të pandehurit ka vlerësuar se janë përmbushur kushtet ligjore që pranimi i fajësisë të aprovohet nga ana e gjykatës. Gjykata ka pranuar deklarinimin e pranimit të fajësisë nga të pandehurit dhe vlerëson se ky pranim i fajësisë është i mbështetur edhe në provat që gjenden në shkresat e lëndës, të gjitha këto vërtetojnë në mënyrë bindëse për gjykatën elementet inkriminuese të veprave penale e ku krijohet edhe figura në tërësi e veprave penale që kanë kryer të pandehurit, andaj mbi këtë bazë edhe gjykata i ka vlerësuar këto prova dhe deklarinimin e pranimit të fajësisë nga të pandehurit e ka pranuar si të tillë.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarve, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, ashtu që posaçërisht rrethanë lehtësuese për të pandehurin e parë ka marr faktin se i pandehuri ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, të njëjtën e ka pranuar në mënyrë vullnetare, i premtonte gjykatës se nuk do të përsëris vepër tjetër penale, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata mori faktin se i akuzuari ka kryer edhe me parë vepra të tjera penale dhe atë: **I.** Në lëndën Penale P.nr.48/2005, nga neni 161 (kanosja), i cili është dënuar me dënim me gjobë 120 (njëqind e njëzet) euro dhe i cili është bërë i plotfuqishëm më 26.05.2005; **II.** Në lëndën Penale P.nr.167/2005, nga neni 153 (lëndim i lehtë trupor), i cili është dënuar me dënim me burgim prej 2 (dy) muaj dhe i cili është bërë i plotfuqishëm më 09.10.2006; **III.** Në lëndën Penale P.nr. 58/2012, nga neni 297 (rrezikim i trafikut publik), i cili është i dënuar me dënim me kusht 3 (tre) muaj burgim brenda një viti dhe i cili është bërë i plotfuqishëm më 29.12.2013; **IV.** Në lëndën Penale P.nr.94/2017, nga neni 333 (asgjësim dëmtim i pasurisë), i cili është i dënuar me vërejtje gjyqësore dhe i cili është bërë i plotfuqishëm më 05.06.2019; **V.** Në lëndën Penale P.nr. 113/2004, nga neni 39 (plagosje e lehtë), i cili është dënuar me dënim me burgim prej 30 (tridhjetë) dite dhe i cili është bërë i plotfuqishëm më 23.06.2004. Për të pandehurin e dytë ka marr faktin se i pandehuri ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, të njëjtën e ka pranuar në mënyrë vullnetare, i premtonte gjykatës se nuk do të përsëris vepër tjetër penale, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata mori faktin se i akuzuari ka kryer edhe me parë vepra të tjera penale dhe atë: **I.** Në lëndën Penale P.nr. 302/2009, nga neni 297 (rrezikim i trafikut publik), i cili është dënuar me dënim me gjobë 250 (dyqind e pesëdhjetë) euro dhe i cili është bërë i plotfuqishëm më 03.06.2011; **II.** Në lëndën Penale P.nr.398/2011, nga neni 252 (vjedhja), i cili është dënuar me dënim me gjobë 200 (dyqind) euro dhe i cili është bërë i plotfuqishëm më 10.04.2012; **III.** Në lëndën Penale PKR.nr.24/2011, nga neni 328 (mbajtja në pronësi, në kontroll, në

posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve), i cili është dënuar me dënim me gjobë 1350 (njëmijë e treqind e pesëdhjetë) euro dhe i cili është bërë i plotfuqishëm më 06.06.2012; **IV.** Në lëndën Penale P.nr. 559/2011, nga neni 322 (heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave), i cili është i dënuar me dënim me kusht 3 (tre) muaj burgim brenda një viti dhe i cili është bërë i plotfuqishëm më 29.05.2014; **V.** Në lëndën Penale PKR.nr.192/2015, nga neni 374 (mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve), i cili është i dënuar me dënim me gjobë 1500 (njëmijë e pesëqind) euro dhe i cili është bërë i plotfuqishëm më 11.01.2016. Të gjitha këto rrethana ndikuan që Gjykata ti zbatoi dispozitat e përgjithshme për zbutjen ose ashpërsimin e dënimit të parapara me nenin 70 të KPRK-së, gjykata ka ardhur në përfundim se të akuzuarit kanë kryer veprat penale të përshkruara në dispozitiv të këtij aktgjykimit, të akuzuarin Q.M. e dënon me dënim me gjobë prej 260 (dyqind e gjashtëdhjetë) euro, ndërsa të akuzuarin M.Th. e dënon me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 100 (njëqind) ditësh, me bindjen se me këto dënime do të arrihen efektet dhe qëllimet e dënimeve nga neni 38 të KPRK-së, dhe këto dënime të shqiptuara sipas bindjes së gjykatës janë në proporcion me veprat penale të kryera dhe rrethanat personale të cilat i posedojnë të akuzuarit.

Vendimi për shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marr bazuar në nenin 449 par. 1 dhe par. 2, nën par. 2.1 dhe 2.6 të KPP-së.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të nenit 364,365 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË/ DEGA NË MALISHEVË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL
P.nr. 10/2024, më 14 mars 2024

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Njazi MORINA

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.